



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPSTINA LIPJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 19 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 85/2010, nenit 12 par.12.2 dhe nenit 17 pika e) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008) dhe nenit 20 pika d) të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.03.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

#### V E N D I M

#### PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS: "TRUNGU I SHPARDHIT (*QUERCUS FRAINETTO*)" NË FSHATIN BREGU I ZI SI MONUMENT I NATYRËS

1. Me këtë vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës "**Trungu i Shpardhit (*Quercus frainetto*)**", në fshatin Bregu i zi të Lipjanit, si Monument i Natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).
  - 1.1. Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse rreth projeksionit të kurorës prej 10 metra përfshinë sipërfaqen prej **5 ari**.
  - 1.2. Monumenti i Natyrës ka pamje karakteristike të kurorës, vjetërsi dhe vlera të tjera natyrore dhe si i tillë është i rrallë jo vetëm për territorin e komunës së Lipjanit por edhe më gjerë.
  - 1.3. Lartësia e kërcellit të Monumentit Natyror është rreth 20 metra, perimetri i kërcellit është 2.5 metra, diametri i kurorës 15 metra dhe vjetërsia është mbi 250 vite.
2. Monumenti i Natyrës gjendet në pronë shoqërore, në parcelën 00023-0, zona kadastrale Bregu i Zi, nr. P-71409087-00023-0, me sipërfaqe 2843 m<sup>2</sup>, e regjistruar si pronë shoqërore.
3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III-të, Natural Monument/Natural Landmark – Monument i Natyrës.

4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi i mbrojtës i shkallës së III-të, në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat në Monumentin e Natyrës ndalohet:

4.1. Prerja e trungut, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe

çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;

4.2. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;

4.3. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur

4.4. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur

4.5. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;

4.6. Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të

Natyrës.

4.7. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera

4.8. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike

4.9. Ndërrimi i kulturës

4.10. Mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mund të ndikojnë në pengimin e pamjes së Monumentit Natyror.

5. Monumenti i Natyrës dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

5.1. Në Monumentin e Natyrës lejohen të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit Natyror nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e

Natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit Natyror si dhe

punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit Natyror.

5.2. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset komuna e Lipjanit, përmes

drejtorisë përkatëse.

5.3. Komuna është e detyruar që:

5.4. Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes;

5.4.1. Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mund ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetit e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;

5.4.2. Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit Natyror në pajtim me Rregulloren për shënjimin e zonave të mbrojtura.

6. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomike-pyjore, hidro-teknike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit Natyror.

7. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15-të) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hyn në fuqi shtatë (7-të) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare dhe në web-faqen zyrtare të komunës së Lipjanit.

Nr. 15-352/01-17293


Lipjan, më 31.03.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi





Harta e Monumentit Natyror “Trungu i Shpardhit (*Quercus frainetto*)”, në Breg të Zi